



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGIJË  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 05 maj 2026  
Kodi i ZRRE: V\_3211\_2026

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,**

Mbështetur në Nenin 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 Nenin 47 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 dhe Nenin 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084); Dispozitat e Nenit 16 dhe Nenit 22 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085); Dispozitat e Nenit 23 dhe Nenin 24 të Ligjit për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë (Ligji Nr. 08/L-258), Dispozitat ligjore të Rregullës Nr. 03/2017 për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (Rregulla për Të Hyrat e OST/OT-së); Dispozitat e Rregullës Nr.10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë; Metodologjinë Nr. 01/2020 për llogaritjen e çmimit referent për Energjinë e prodhuar nga Burimet e Ripërtërishme, Dispozitat e Rregullës Nr. 01/2025 për Mekanizmin Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme, Vendimin V\_3147\_2026 të datës 22 prill 2026, Njoftimin e ZRRE-së, për Azhurnimet vjetore të të Hyrave dhe Tarifave për OST/OT, OSSH dhe FSHU, Nr. 1118/25 të datës 12.12.2025; dhe Aplikacionin e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut – OST/OT (KOSTT SH.A.), për azhurnimet vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për vitin 2026, të dorëzuar në ZRRE Nr. 097/26 të datës 29 janar 2026,

në seancën e mbajtur më 05 maj 2026 nxori këtë:

**V E N D I M**

- I. **APROVOHEN TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (në tekstin e mëtejme: HLM)** që do të mblidhen nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (OST/OT-KOSTT SH.A.), për vitin relevant tarifor 2026.
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mblidhen nga OST/OT për vitin relevant tarifor 2026 duke përfshirë Fondin për Burimet e Ripërtërishme janë gjithsejtë në shumën e 76,484,096 €.
- III. Fondi i Burimeve të Ripërtërishme bazuar në prodhimin e planifikuar të energjisë nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë për vitin relevant tarifor 2026 është në shumën e 6,849,985 €.
- IV. Çmimi referent i Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, i cili do të aplikohet për vitin tarifor 2026 është 88.58 €/MWh.
- V. **OBLIGOHET** - Operatorit të Sistemit, Transmisionit, Operatori i Tregut (OST/OT) në përputhje me Metodologjinë e Përcaktimit Tarifave të Operatorit të Sistemit Transmetimit, Operimit të Sistemit, Tregut dhe Metodologjinë e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit, që të përgatisë dhe dorëzojë për aprovim në ZRRE tarifat e transmisionit, operimin e sistemit dhe operimin e tregut bazuar në HLM e OST/OT-së, si dhe tarifat për Fondin e Burimeve të Ripërtërishme për Energji (BRE), sipas këtij Vendimi.
- VI. Ky vendim do të zbatohet nga Operatori i Sistemit të Transmisionit, Operatori i Tregut (OST/OT-KOSTT) duke filluar nga data 1 maj 2026.



## ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejshëm: ZRRE) më datë 12 dhjetor 2025, ka iniciuar procesin: Azhurnimet Vjetore të të Hyrave dhe Tarifave për Operatorët e Rregulluar, duke përfshirë edhe Operatorin e Sistemit, të Transmisionit dhe Operatorin e Tregut (OST/OT), për vitin relevant tarifor 2026.
- ZRRE sipas dokumentit iniciues dhe njoftimit publik, ka vlerësuar se ky proces i Azhurnimeve vjetore të të hyrave dhe tarifave për vitin relevant tarifor 2026, ka për qëllim që të sigurojë që të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për të licencuarit e rregulluar të jenë në përputhje dhe në pajtueshmëri me kostot reale dhe parashikimet për periudhën tarifore.
- ZRRE ka njoftuar se në pajtim me Rregullat e të Hyrave për të Licencuarit, parashikimet duhet azhurnohen për të marr parasysh dallimet nëpërmjet vlerave të parashikuara ndaj atyre të realizuara. Pra, përshtatjet barten në vitin vijues, përkatësisht dallimet e vitit t-1 barten në vitin “t” në kuadër të procesit relevant tarifor. Gjithashtu, ZRRE ka theksuar se pas mbledhjes së të dhënave relevante nga të licencuarit, do të analizoj dhe vlerësoj aplikacionet e të licencuarve për të përcaktuar kostot reale që reflektohen në tarifatat përkatëse.
- ZRRE ka theksuar se, në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ka mandat për përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale dhe tarifave për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesin me Shërbim Universal, duke siguruar që tarifatat të reflektojnë kostot reale dhe të arsyeshme të shërbimit.
- ZRRE, përmes njoftimit ka theksuar se, do të publikojë aplikacionet sapo të vlerësohen si të kompletuara dhe siguron palët e interesit që vendimet përfundimtare do të marrin parasysh të dhënat relevante dhe komentet e tyre.
- Gjatë procesit të shqyrtimit të aplikacionit për të hyrat e lejuara maksimale, ZRRE përmes korrespondencave të vazhdueshme, ka kërkuar nga OST/OT SH.A. dhënien e informacione shtesë, përditësime të dhënave, argumenteve dhe dokumentacionit justifikues lidhur me të gjitha çështjet e evidentuara në mënyrë që të kemi transparencë për marrjen e një vendimi të drejtë e kosto reflektues të tarifave.
- ZRRE më datë 29 janar 2026 nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut – KOSTT Sh.A., ka pranuar aplikacionin për azhurnimet vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për vitin relevant tarifor 2026, duke paraqitur të dhënat e realizuara për vitin 2025 dhe kërkesat për vitin 2026.
- KOSTT sh.a. në aplikacionin e saj, ka paraqitur arsyetimet lidhur me ndryshimet operative dhe kapitale, përfshirë shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, kostot e humbjeve në transmision, kostot e shërbimeve ndihmëse, mekanizmin ITC, Fondin për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, si dhe kërkesat për projekte të reja investive.
- ZRRE, gjatë vlerësimit fillestar dhe shqyrtimit të aplikacionit, ka zhvilluar proces të detajuar të verifikimit dhe validimit të të dhënave të paraqitura nga OST/OT, përfshirë sqarimet shtesë, përditësimet dhe korrigjimet e nevojshme, me qëllim që të sigurojë që të dhënat e përdorura në llogaritjet tarifore të jenë të plota, të sakta dhe të konsoliduara. Gjithashtu, ZRRE ka inkorporuar



Bilancin e përditësuar të Energjisë Elektrike të pranuar nga KOSTT, KEDS dhe KESCO, duke reflektuar zhvillimet më të fundit në sektorin elektroenergjetik. Operatori i Sistemit, të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT), dhe palët tjera të interesit kanë pasur mundësi t'i paraqesin komentet e tyre përmes konsultimit publik për periudhë dy javore.

- ZRRE më datë 10 prill 2026 ka publikuar Raportin Konsultativ për Përshtatjet Vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OST/OT për vitin relevant tarifor 2026, me qëllim të garantimit të transparencës procedurale dhe përfshirjes së palëve të interesit në procesin vendimmarrës. Përmes këtij raporti, ZRRE ka paraqitur vlerësimet fillestare lidhur me komponentët e HLM-së, dhe ka ftuar palët e interesit që të paraqesin komentet dhe kundërshtimet e tyre të arsyetuara.
- ZRRE përmes Raportit Konsultativ për OST/OT ka sqaruar se përshtatjet e rregullta janë mekanizëm kyç rregullator që mundësojnë përditësimin e të hyrave për të reflektuar ndryshimet ndërmjet vlerave të parashikuara dhe atyre reale të kostove që janë jashtë kontrollit të ndërmarrjeve të rregulluara, përfshirë inflacionin, kostot e blerjes së energjisë, vëllimet e energjisë dhe faktorë të tjerë relevant.
- ZRRE përmes Raportit Konsultativ ka theksuar se, në kuadër të procesit të përshtatjeve të rregullta, shqyrtohen vetëm komponentët e kostos që ndryshojnë nga viti në vit, ndërsa parametrat bazë rregullator të përcaktuar në kuadër të Shqyrtimit Periodik Tarifor 2023–2027 mbeten në fuqi gjatë gjithë periudhës rregullative.
- Raporti konsultativ ka trajtuar indeksimin e kostove operative dhe kapitale të OST/OT-së, në përputhje me dispozitat e Rregullës mbi të Hyrat e Lejuara Maksimale për OST/OT. Në pajtim me metodologjinë rregullatore, Shpenzimet e Lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes (OPEX), kostoja e zhvlerësimit dhe kthimi i lejuar indeksohen me normën e inflacionit bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumatorit (HICP) të publikuar nga Eurostat për vendet e Eurozonës.
- ZRRE ka vlerësuar se norma e inflacionit për vitin 2025 prej 2.13% duhet të reflektohet në komponentët relevant të kostove të lejuara për vitin 2026, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit financiar të operatorit të rregulluar dhe sigurimit të reflektimit të kostove reale në tarifat përkatëse. Në këtë drejtim, ZRRE ka analizuar aplikacionin e OST/OT-së, duke përfshirë kërkesat për ndryshime në projektet investive dhe burimet e financimit për projektet kapitale. Prandaj, ZRRE ka vlerësuar se kostot e lejuara për vitin 2026 duhet të aprovohen në nivelin prej 8.106 milion € për OPEX, 14.381 milion € për zhvlerësim dhe 11.236 milion € për kthimin e lejuar, duke konsideruar se vetëm kostot e arsyeshme, të justifikuara dhe në përputhje me metodologjinë rregullatore duhet të reflektohen në të Hyrat e Lejuara Maksimale të OST/OT-së.
- Raporti konsultativ ka trajtuar gjithashtu kostot e shërbimeve ndihmëse për vitin 2026, ku ZRRE ka shqyrtuar kërkesën e OST/OT-së, lidhur me kostot e shërbimeve ndihmëse për vitin relevant tarifor 2026, në funksion të obligimeve ligjore dhe teknike të operatorit për sigurimin e operimit të sigurt, stabil dhe të besueshëm të Sistemit Elektroenergjetik të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, ZRRE ka vlerësuar dispozitat e Ligjit për Energjinë Elektrike, Kodit të Rrjetit, Rregullave të Tregut dhe obligimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Këqjes KOSTT–ENTSO-E lidhur me sigurimin e rezervave balancuese dhe shërbimeve ndihmëse.
- KOSTT sh.a. në aplikacionin e saj, OST/OT ka kërkuar aprovimin e kostove të shërbimeve ndihmëse në shumën prej 45.00 milion €, të lidhura kryesisht me sigurimin e rezervave



automatike dhe manuale të frekuencës (aFRR dhe mFRR) për balancimin e sistemit elektroenergjetik. Gjatë shqyrtimit të aplikacionit, ZRRE ka analizuar kostot e realizuara për vitin 2025, të dhënat operative, kontratat ekzistuese për sigurimin e rezervave dhe informacionet paraprake për realizimet gjatë vitit 2026.

- ZRRE bazuar në analizën rregullatore dhe vlerësimin e të dhënave të realizuara, ka konsideruar se niveli i kostove të propozuara nga OST/OT nuk mund të pranohej në tërësi si i arsyeshëm dhe kosto-efektiv. Për këtë arsye, ZRRE ka propozuar njohjen e kostove të shërbimeve ndihmëse në shumën prej 39.64 milion €, duke vlerësuar se kjo shumë paraqet nivel të arsyeshëm të kostove të nevojshme për operimin e sigurt të sistemit, duke mbrojtur njëkohësisht konsumatorët nga bartja e kostove të paarsyeshme në tarifa.
- Raporti konsultativ ka trajtuar gjithashtu kostot e humbjeve në transmision për vitin 2026, ku ka shqyrtuar parashikimin e kostove të humbjeve në transmision për vitin relevant tarifor 2026, bazuar në Bilancin e Energjisë Elektrike, nivelin e humbjeve të lejuara në transmision dhe parashikimin e çmimeve të energjisë për mbulimin e humbjeve. Gjatë këtij procesi, ZRRE ka marrë në konsideratë të dhënat e përditësuara të sistemit elektroenergjetik, përfshirë disponueshmërinë e kapaciteteve gjeneruese vendore, importet dhe zhvillimet në tregjet rajonale të energjisë.
- ZRRE ka vlerësuar se niveli i humbjeve të lejuara prej 1.75% mbetet në fuqi edhe për vitin 2026, ndërsa dallimet ndërmjet propozimeve të OST/OT-së, dhe vlerësimeve të ZRRE-së, kanë rezultuar kryesisht nga përditësimi i Bilancit të Energjisë Elektrike dhe nga metodologjia e përdorur për vlerësimin e çmimit mesatar të energjisë për mbulimin e humbjeve. Në këtë drejtim, ZRRE ka analizuar të dhënat historike të tregut ALPEX dhe HUPEX, realizimet e vitit 2025 dhe projeksionet për vitin 2026.
- ZRRE, pas analizimit të aplikacionit dhe dokumentacionit mbështetës, ka vlerësuar se çmimi mesatar i energjisë për mbulimin e humbjeve duhet të përcaktohet në nivelin prej 93.14 €/MWh, ndërsa kostot e humbjeve në transmision duhet të aprovohen në shumën prej 12.11 milion €, duke konsideruar se vetëm kostot e arsyeshme, të verifikuara dhe në përputhje me kushtet reale të tregut duhet të reflektohen në tarifat e rregulluara.
- ZRRE, përmes mekanizmit të faktorit korrigjues të të hyrave (KREVt), ka reflektuar dallimet ndërmjet kostove të lejuara dhe kostove reale të realizuara gjatë vitit paraprak 2025 për komponentët e kostove që janë jashtë kontrollit të të licencuarit, përfshirë humbjet, shërbimet ndihmëse dhe Fondin për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE). Në këtë drejtim, ZRRE ka konstatuar se këto dallime nuk ndikojnë në nivelin total të të hyrave të lejuara, por vetëm në shpërndarjen e tyre ndërmjet komponentëve tariforë për vitin relevant tarifor 2026.
- ZRRE ka vlerësuar se për shkak të prodhimit më të ulët të realizuar nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë gjatë vitit 2025 krahasuar me prodhimin e planifikuar, kostot reale të Fondit për BRE kanë rezultuar më të ulëta, duke krijuar nënshpenzim në shumën prej 5,636,937 €. Për këtë arsye, kjo diferencë është reflektuar në përlllogaritjen tarifore të vitit 2026, me ç'rast kostoja totale e Fondit për BRE për vitin relevant tarifor 2026, në shumën prej 6,849,985 €, është përshtatur për qëllime tarifore në shumën prej 1,213,048 €, e cila përbën bazën për përlllogaritjen e tarifës së Fondit për BRE për vitin 2026.



- Raporti konsultativ ka trajtuar edhe përlogaritjen e çmimit referent për energjinë elektrike të gjeneruar nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE), në përputhje me Metodologjinë për Llogaritjen e Çmimit Referent për Energjinë Elektrike të Gjeneruar nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë. Gjatë shqyrtimit të aplikacionit, është konstatuar se OST/OT në aplikimin fillestar nuk kishte përditësuar çmimin referent dhe kishte përdorur vlerën e vitit 2025 prej 65.12 €/MWh. Për këtë arsye, ZRRE ka kërkuar përditësimin e çmimit referent në pajtim me metodologjinë në fuqi dhe zhvillimet aktuale të tregut, me ç'rast çmimi referent për vitin 2026 është vlerësuar në nivelin prej 88.58 €/MWh, duke konsideruar se ky nivel reflekton në mënyrë më reale kushtet e tregut dhe siguron zbatim të drejtë të mekanizmave mbështetës për BRE-të.
- Raporti konsultativ ka trajtuar, edhe faktorin korigjues për vitin e realizuar 2025, ku ZRRE në përputhje me Rregullën mbi të Hyrat e Lejuara Maksimale për OST/OT a kryer vlerësimin e faktorëve korigjues të të hyrave për vitin e realizuar 2025, bazuar në dallimet ndërmjet kostove aktuale të lejuara dhe të hyrave reale të realizuara nga OST/OT. Gjatë këtij procesi, ZRRE ka shqyrtuar kostot operative, kostot e humbjeve, të hyrat jo-tarifore dhe komponentët tjerë relevantë të raportuar nga OST/OT, duke aplikuar parimet e efikasitetit, arsyeshmërisë dhe pranueshmërisë së kostove. Si rezultat i vlerësimit rregullator dhe njohjes vetëm të kostove të verifikuara dhe të justifikuara, ZRRE ka përcaktuar faktorin e përshtatjes së të hyrave (KREVT) i cili ka rezultuar negativ të të hyrave në shumën prej -2.527 milion €, i cili bartet në përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale për vitin relevant tarifor 2026.
- ZRRE përmes Raporti konsultativ ka paraqitur edhe propozimin për të hyrat e Lejuara Maksimale për OST/OT për vitin 2026, ku pas shqyrtimit të aplikacionit të OST/OT-së, analizimit të të dhënave financiare, operative dhe teknike, trajtimit të komenteve të palëve të interesit dhe vlerësimit të të gjithë komponentëve relevantë tariforë në përputhje me legjislacionin sekondar dhe metodologjitë rregullatore në fuqi, ZRRE ka vlerësuar në Raportin Konsultativ se të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut për vitin relevant tarifor 2026 propozohen që të aprovohen në shumën prej 75.858 milion €, duke përfshirë edhe Fondin për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë. ZRRE konsideron se ky nivel i të hyrave siguron mbulimin e kostove të arsyeshme dhe të nevojshme për operimin e sigurt, stabil dhe efikas të sistemit elektroenergjetik, duke mbrojtur njëkohësisht interesat e konsumatorëve dhe duke garantuar zbatim të drejtë të parimeve të rregullimit ekonomik.
- ZRRE gjatë procesit të konsultimit publik për Raportin Konsultativ lidhur me Përshtatjet Vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për vitin relevant tarifor 2026 ka pranuar komente dhe rekomandime nga Organizata e Shoqërisë Civile INDEP, si dhe nga të licencuarit KOSTT, KEDS, KESCO, KEK dhe Elektroserver. Komentet e paraqitura kanë trajtuar çështje që ndërlidhen me procesin e përshtatjeve tarifore, kostot operative dhe kapitale, kostot e humbjeve, kostot e shërbimeve ndihmëse, Fondin për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, kostot e importit, faktorët korigjues të të hyrave dhe komponentët tjerë relevantë të të Hyrave të Lejuara Maksimale. ZRRE ka shqyrtuar të gjitha komentet dhe dëshmitë e paraqitura gjatë procesit konsultativ dhe ka vlerësuar secilin pretendim në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, metodologjitë tarifore dhe parimet e rregullimit ekonomik.
- ZRRE pas shqyrtimit të komenteve të pranuar dhe analizimit të të dhënave të përditësuara të dorëzuara nga të licencuarit, ka përgatitur Raportin Final për Përshtatjet Vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për vitin tarifor 2026. Në këtë Raport janë reflektuar ndryshimet dhe përditësimet e nevojshme të bazuara në realizimet reale për tre muajt e parë të vitit 2026, përditësimet e Bilancit të Energjisë Elektrike, si dhe vlerësimet përfundimtare të ZRRE-së, lidhur



me komponentët relevantë tarifor. ZRRE ka theksuar se Raporti Final është përgatitur në funksion të garantimit të një procesi transparent, objektiv dhe kosto-reflektues të përcaktimit të të Hyrave të Lejuara Maksimale për operatorët e rregulluar.

- ZRRE në Raportin Final, ka vlerësuar se për OST/OT, ndryshimet ndërmjet Raportit Konsultativ dhe vlerësimeve përfundimtare lidhen kryesisht me përditësimin e kostove të blerjes së energjisë për humbjet dhe kostove të shërbimeve ndihmëse, bazuar në realizimet reale për muajt janar–mars 2026 dhe të dhënat më të fundit operative të dorëzuara nga KOSTT. Si rezultat i këtij vlerësimi, ZRRE ka propozuar që të Hyrat e Lejuara Maksimale për OST/OT për vitin 2026 të aprovohen në shumën prej 76.484 milion €, vlerë kjo për 0.625 milionë € më e lartë se propozimi në Raportin Konsultativ.
- ZRRE në Raportin Final ka reflektuar kostot reale të realizuara për muajin mars 2026 dhe ka përditësuar parashikimet për pjesën e mbetur të vitit tarifor, me ç’rast kostoja e lejuar për humbjet në transmision është ulur nga 12.112 milionë € në Raportin Konsultativ në 12.068 milionë € në Raportin Final. ZRRE ka vlerësuar se ky përditësim reflekton më saktë zhvillimet aktuale të tregut dhe të dhënat reale të disponueshme gjatë procesit të vlerësimit tarifor.
- ZRRE në Raportin Final ka vlerësuar komentet dhe të dhënat e përditësuara të dorëzuara nga KOSTT lidhur me realizimet për periudhën janar–mars 2026, të bazuara në raportet mujore operative dhe kontratat për sigurimin e rezervave balancuese. Pas analizimit të kostove reale dhe projeksioneve për muajt vijues të vitit 2026, ZRRE ka propozuar rritjen e kostove të lejuara të shërbimeve ndihmëse nga 39.64 milionë € në Raportin Konsultativ në 40.309 milionë € në Raportin Final, duke konsideruar se kjo vlerë paraqet nivel të arsyeshëm dhe të justifikuar të kostove të nevojshme për operimin e sigurt dhe stabil të sistemit elektroenergjetik.
- ZRRE, gjatë shqyrtimit të komenteve të INDEP lidhur me kostot e shërbimeve ndihmëse, transparencën e prokurimit dhe kostot e humbjeve në transmision, ka vlerësuar se metodologjia e aplikuar për përcaktimin e kostove të lejuara është bazuar në të dhënat më të fundit reale të disponueshme, çmimet aktuale të tregut dhe parimet e rregullimit të kujdesshëm dhe kosto-reflektues. Gjithashtu, ZRRE ka theksuar se OST/OT dorëzon në mënyrë të vazhdueshme dokumentacionin dhe dëshmitë relevante për prokurimin e shërbimeve ndihmëse dhe se kostot e pranuar në tarifa janë subjekt i verifikimit dhe validimit rregullator. Në lidhje me komentet e INDEP për Fondin për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, ZRRE ka konstatuar se gjatë procesit të shqyrtimit tarifor ka përditësuar çmimin referent për vitin 2026 në pajtim me metodologjinë në fuqi dhe zhvillimet aktuale të tregut, me ç’rast çmimi referent është përcaktuar në nivelin prej 88.58 €/MWh. Si rezultat i këtij përditësimi, kostoja e Fondit për BRE është ulur nga 18.68 milionë € të propozuara nga KOSTT në 6.85 milionë €, duke shmangur bartjen e kostove të pajustificuara tek konsumatorët fundor.
- Andaj, të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mblidhen nga OST/OT duke përfshirë Fondin për Burimet e Ripërtërishme për vitin relevant tarifor 2026 janë gjithsejtë në shumë e 76,484,096 €, ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij Vendimi.
- Po ashtu, bazuar në analizimin dhe vlerësimin e të dhënave të dorëzuara nga OST/OT, metodologjinë rregullatore në fuqi, komentet e palëve të interesit dhe vlerësimet e përfshira në Raportin Final për OST/OT, ZRRE ka konstatuar se kostot e Fondit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë dhe çmimi referent për vitin relevant tarifor 2026 duhet të aprovohen siç janë reflektuar në dispozitiv të këtij vendimi.



- o Vlen të theksohet që të Hyrat e Lejuara Maksimale për OST/OT-në do t'i nënshtrohen procesit të Përshtatjeve të Rregullta Vjetore, sipas Rregullës Nr. 03/2017 për Të Hyrat e OST/OT-së, të nxjerr nga ZRRE.
- o Bordi i ZRRE-së pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**VII.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


**VIII.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.


**Bordi i ZRRE-së:**

  
\_\_\_\_\_


Ymer Fejzullahu, kryesues

  
\_\_\_\_\_


Lutfije Dervishi, anëtare

  
\_\_\_\_\_

Gani Buçaj, anëtar

  
\_\_\_\_\_

Arta Isufi, anëtare

  
\_\_\_\_\_

Adnan Preniqi, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KOSTT,
- KEDS, dhe KESCO
- Arkivit të ZRRE-së.